



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

VENDIM

Nr. 199, datë 17.04.2024

PËR

KUALIFIKIMIN E KANDIDATES {...}

**DHE VIJIMIN E PROCEDURËS SË LËVIZJES PARALELE NË
GJYKATËN E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
DURRËS, PËR POZICIONIN E LIRË TË SHPALLUR ME
VENDIMIN NR. 86, DATË 20.02.2024, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 17.04.2024, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e tre kritereve ligjore të kandidimit për lëvizjen paralele, të kandidatës znj. {...}”, përgatitur nga relatori, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për verifikimin e plotësimin nga kandidatja znj. {...}, në procedurat për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 86, datë 20.02.2024, të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”

VËREN

I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Me disa vendime të datës 20.02.2024, Këshilli i Lartë Gjyqësor (*më poshtë referuar si Këshilli*) hapi katërmbëdhjetë procedura të lëvizjeve paralele në gjykatat e shkallës së parë, ndër to, me vendimin nr. 86, procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të JP Durrës, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale.
2. Afati i kandidimit për këto procedura të lëvizjes paralele si më lart u përcaktua deri më datë 01.03.2024.
3. Brenda afatit të kandidimit për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 86, datë 20.02.2024 (*më poshtë referuar si vendimi 86/2024*, kandidoi edhe znj. {...} (*më poshtë referuar si kandidatja*), me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të JP Fier.
4. Pas përfundimit të afatit të kandidimit për procedurat e lëvizjes paralele, mbështetur në pikën 9, të vendimit 86/2024, mbi propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, me vendimin nr. 127, datë 11.03.2024, Këshilli miratoi listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë një vlerësim etike dhe profesionale për efekt të kandidimit në procedurat

e shpallura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë. Në këtë listë është përfshirë dhe znj. {...}.

5. Kandidatja më parë kishte aplikuar në pozicione të lëvizjes paralele. Kandidatja znj. {...}, në zbatim të pikës 5 të nenit 43 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (*më poshtë referuar si Ligji për Statusin*), ka njoftuar se ka hequr dorë nga kandidimi për 1(një) pozicion të lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan (pozicioni nr.252). Duke qenë se Këshilli nuk kishte filluar procedurën e verifikimit për kandidatët pa vlerësim në këtë pozicion, nuk është shprehur me vendimin për këtë tërheqje nga kandidimi (cituar në relacionet e këtij pozicioni dhe renditjen për kandidaten znj. Suela Lika).
6. Në vijim, me vendimin nr. 140, datë 13.03.2023, Këshilli ka vendosur: “*III. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Durrës, të shpallura me vendimet nr. 84, dhe 86 datë 20.02.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që kanë ose mund të kenë 1(një) vlerësim. IV. Caktimin e relatorit për secilin kandidat, si më poshtë: 3. Për kandidaten znj. {...} - relator z. Klodian Kurushi; ...*”.
7. Më datë 18.03.2024, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në vendimin e Këshillit nr. 320, datë 17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve” (*më poshtë referuar si vendimi 320/2020*), në rrugë elektronike, kandidatja u njoftua: i) për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit; ii) për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; iii) për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtar tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.
8. Brenda afatit të përcaktuar, kandidatja nuk parashtroi ndonjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj tij apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
9. Në vijim të procedurës së verifikimit, bazuar në pikën 55, Seksioni C, Kreu V, të vendimit 320/2020, përmes shkresave të veçanta, për kandidaten znj. {...} u kërkua dhe u administrua informacioni i nevojshëm nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, si organi kompetent për krijimin dhe administrimin e dosjeve personale dhe regjistrin të gjyqtarëve, si dhe nga gjykata ku kandidatja ka ushtruar funksionin e gjyqtarit.
10. Për verifikimin e kriterëve të “përvojës profesionale minimale specifike” dhe atij të “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, më datë 19.03.2024 përcolli informacionin dhe dokumentacionin përkatës të administruar për kandidaten znj. {...}, siç do të përshkruhet më poshtë.
11. Sa i përket kriterit të “përvojës profesionale minimale specifike” të kandidatës në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë ku ajo ka kandiduar, pra në fushën e të drejtës penale, referuar gjykatave ku kandidatja ka ushtruar funksionin e gjyqtarit,

informacioni u kërkuar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier. Nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier informacioni i kërkuar është përcjell postës elektronike datë 18.03.2024, siç do të përshkruhet më poshtë.

II. REZULTATET E VERIFIKIMIT TË KRITEREVE TË KANDIDIMIT

A. Për kandidaten znj. {...} u verifikua kriteri i “Përvojës profesionale specifike minimale”

12. “Përvoja profesionale specifike minimale” për lëvizjen paralele të gjyqtarit në gjykatën e shkallës së parë, në rastin konkret në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, që gjen reflektim në shkronjën “a”, të pikës 5, të vendimit 86/2024, është parashikuar në pikën 6, të nenit 43, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“Magjistrati nuk ka të drejtë të kandidojë në rast se gjatë pesë viteve të fundit nuk ka të paktën një vit përvojë profesionale në fushën përkatëse të së drejtës për pozicionin e lirë ...”*.
13. Për verifikimin e kandidates në lidhje me plotësimin e këtij kriteri për lëvizjen paralele u mbajt parasysht se ajo ka kandiduar për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, çka do të thotë se kandidatja duhet të ketë të paktën një vit përvojë profesionale si gjyqtar në fushën e së drejtës penale gjatë pesë viteve të fundit para kandidimit.
14. Në lidhje me përvojën e profesionale, në kërkesën për shprehje interesi dhe në jetëshkrimin e dorëzuar nga kandidatja, evidentohet se ka përvojë si në seksionin civil dhe atë penal. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, Znj. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datë 30.06.2003, ka përfunduar pranë Universitetit “Justiniani I” ciklin e dytë të studimeve Master në Shkenca Juridiko-Penale në vitin 2011 dhe Master Shkencor në “Legjislacioni dhe Institucionet Europiane” pranë Institutit të Studimeve Europiane, UT në vitin 2015 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2020.
Me vendim nr. 480, datë 20.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor emërohet gjyqtar.
Me vendim nr. 521, datë 27.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.
Me vendim nr. 131, datë 28.03.2023 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier”, nga data 01.05.2023 transferohet në pozicion të përhershëm si gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, ku dhe aktualisht ushtron funksionin.
Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 3 vite.
Znj. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.
15. Në lidhje me përvojën specifike profesionale në pesë vitet e fundit, sipas informacionit të përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, nga verifikimet e kryera, rezulton se për kandidaten: *“Me Urdhër Nr.3 Prot., datë 05.01.2017 të Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje, është urdhëruar që gjyqtarët e Gjykatës së rrethit*

gjqësor Lushnjë, do të gjykojnë të gjitha llojet e çështjeve pa ndarje në dhomë civile (çështje civile, tregtare, familjare) dhe Dhomë Penale apo seksione...”.

Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, sipas urdhrit të Këshillit të Gjykatës, gjykon në seksionin penal.

16. Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se kandidatja znj. {...}, deri në momentin e kandidimit për lëvizjen paralele, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 86, datë 20.02.2024, rezulton të ketë mbi një vit përvojë profesionale specifike minimale si gjyqtare në fushën e së drejtës penale gjatë pesë viteve të fundit përpara kandidimit, duke plotësuar kështu kriterin e “përvojës specifike”.

B. Për kandidaten znj. {...} u verifikua edhe kriteri i “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.

17. “Mospasja masë disiplinore në fuqi” si kriter ndalues për lëvizjen paralele të gjyqtarit në gjykatën e shkallës së parë, që gjen reflektim në shkronjën “b”, të pikës 5, të vendimit 86/2024, është parashikuar në pikën 6, të nenit 43, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“Magjistrati nuk ka të drejtë të kandidojë nëse ka në fuqi një masë disiplinore.”*
18. Në lidhje me këtë kriter, në rastin e aplikimit, kandidatja ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit “Për masa disiplinore” datë 01.03.2024, nëpërmjet të cilit, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: *“Nuk kam masë disiplinore në fuqi”.*
19. Sipas informacionit të përcjell nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidatja znj. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.
20. Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se nuk vërtetohet që kandidatja znj. {...} të ketë masë disiplinore në fuqi, duke plotësuar kështu kriterin e “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.

C. Për kandidaten znj. {...} u verifikua edhe kriteri i “papajtueshmërisë ambientale”,

21. “Papajtueshmëria ambientale” si kriter ndalues për lëvizjen paralele të gjyqtarit në gjykatën e shkallës së parë, që gjen reflektim në shkronjën “c”, të pikës 5, të vendimit 86/2024, është parashikuar në nenin 8, pika 2, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“Këshillat, gjatë ... transferimit, ..., për aq sa është e mundur dhe pa cenuar në mënyrë joproporcionale të drejtën për zhvillimin normal të karrierës profesionale të magjistratit, marrin masa për të shmangur papajtueshmërinë ambientale, sipas pikës 3, të këtij neni, me qëllim që të garantohet besimi i publikut në sistemin e drejtësisë, pavarësia dhe paanësia e magjistratit, eficienta e gjykatave dhe zyrave të prokurorisë në dhënien e drejtësisë”.* Ndërkohë, kuptimi i papajtueshmërisë ambientale përcaktohet në pikën 1, të kësaj dispozite ligjore, sipas të cilës: *“Papajtueshmëria ambientale, në kuptimin e këtij neni, krijohet për shkak të lidhjeve të ngushta familjare mes magjistratëve, që janë përkatësisht bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, ose të afërmit e tij deri në*

shkallë të dytë”. Sa i takon rasteve të papajtueshmërisë ambientale për sa lidhet me lëvizjen paralele, ato parashikohen në pikën 3, shkronja “a”, të kësaj dispozite ligjore, ku përcaktohet se: *“Papajtueshmëri ambientale përbëjnë rrethanat e mëposhtme: a) nëse respektivisht në të njëjtën gjykatë ose prokurori ku magjistrati kërkon të caktohet, ushtron funksionin një magjistrat tjetër, që ndodhet në kushtet e pikës 1 të këtij neni”*.

22. Në lidhje me papajtueshmërinë ambientale, në rastin e aplikimit, në përputhje me detyrimin sipas nenit 8, pika 5, të Ligjit për Statusin, kandidatja ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit “Për situatën e papajtueshmërisë ambientale” datë 01.03.2024, nëpërmjet të cilit, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: *“Nuk do të ndodhem në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”*.
23. Gjatë verifikimit, nuk rezultoi ndonjë e dhënë e ndryshme nga ajo e deklaruar nga kandidatja në lidhje me situatën e papajtueshmërisë ambientale për sa ajo kandidon për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.
24. Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se për kandidaten znj. {...} nuk vërtetohet të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele në gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, duke plotësuar kështu kriterin e “papajtueshmërisë ambientale”.

III. KONKLUZIONE

25. Referuar kërkesave të Vendimit 320/2020, duke mbajtur parasysh edhe përcaktimet e Vendimit të Këshillit nr. 86 datë 20.02.2024, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit paraprak të tre kriterëve formale të kandidimit të znj. {...} për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin në fushën e të drejtës penale, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.
26. Bazuar në sa më lart është parashtruar mbi rezultatet e verifikimit paraprak të tre kriterëve formale të kandidimit për kandidaten znj. {...}, konkretisht të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidatja i plotëson ato, ndërsa nuk ekziston ndonjë shkak për skualifikimin e saj nga kandidimi në lidhje me këto kriterë. Nisur nga kjo, Këshilli çmon se është vendi për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, të tre kriterëve të sipërpërmendura të kandidimit për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 86 datë 20.02.2024.

PËR KËTO ARSYE

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 8 dhe në pikën 6, të nenit 43, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në vendimin

e tij nr. 320, datë 17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”, si dhe në pikën 10, të vendimit të tij nr. 86, datë 20.02.2024, “Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së parë të juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale”, pasi shqyrtoi materialet e çështjes dhe relacionin e përgatitur nga relatori, z. Klodian Kurushi,

VENDOSI:

1. Kualifikimin e kandidates znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 86 datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR